



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 29, datë 16.09.2020

**PËR NOFTIMIN E SUBJEKTIT QË E KA VËNË NË LËVIZJE, PRESIDENTIN E REPUBLIKËS, PËR TË VLERËSUAR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT NË GJYKATËN KUSHTETUESE, VAKANCË E PARAKOHSHME, TË SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018 DHE TË RISHPALLUR NË DATËN 27.09.2019**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 229 dhe pikës 1 të nenit 234 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 32 dhe shkronjës “a” të pikës 49 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe të rishpallur në datën 27.09.2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZËVENDËSKRYETARE

Vitore TUSHI

